

**VENDIM**  
**PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Sot, më datë 07.03. 2006, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor - Tiranë, **Blerina Muça**, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Administratori i Vetëm i Shoqërisë "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k., Z Filippo Bugoloni, shtetas italian, lindur në Trento, 19.03.1973, banues në Lomaso (TN), Itali, me pasaportë.nr. 891349R. si dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur, lidhur me regjistrimin e Shoqërisë "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k., në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

**KONSTATOVA:**

Më datë 27.01.2006, është themeluar shoqëria "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k.

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë deri më datë 31.12.2050.

Shoqëria "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

- aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje me pasuritë e paluajtëshme, si për llogari të vet ashtu edhe për llogari të enteve publike dhe private, si edhe ndërtimin, restaurimin, riparimin, shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhënien me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të paluajtëshme të veta, të të tretëve ose të dhëna me qera financiare, tregtare ashtu edhe industriale, edhe të mobiluara, lidhja e kontratave të sipërmarrjes sidhe zhvillimi i të gjitha aktiviteteve të lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje me pasuritë e paluajtëshme në përgjithësi përfshirë aktivitetin e ndërmjetësimit në lidhje me pasuritë e paluajtëshme;
- aktivitetin në lidhje me pjesëmarrjen në shoqëri dhe/ose ente të çfardo lloji, me përjashtim të atyre publike, sidhe aktivitetin për koordinimin teknik dhe financiar të shoqërive pjesëmarrëse;
- aktivitetin tregtar, për llogari të vet dhe/ose të të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes së përfaqësimeve dhe/ose mandateve të agjensisë, në Itali dhe jashtë saj, të produkteve dhe pajisjeve për ndërtim, materialeve porfirike dhe derivateve të tyre, përfshirë gurin natyror, materialet inerte, përzierjet me përbërje bitumi, beton të ambalazhuar, materiale ndërtimi dhe makineri për ndërtim si dhe çdo gjë tjetër e lidhur direkt ose indirekt edhe me përdorimin e tyre;
- aktivitetin tregtar, për llogari të vet dhe/ose të të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes së përfaqësimeve dhe/ose mandateve të agjensisë, në Itali dhe jashtë saj, të mobiljeve dhe orendive të brëndshme në përgjithësi, si dhe me porosi, përfshirë projektimin dhe realizimin e tyre;

- aktivitetin e përpunimit dhe menaxhimit të të dhënave në përgjithësi, që nënkupton thjesht manipulimin informatik të tyre, si dhe aktivitetin e asistencës dhe ofrimin e shërbimeve administrative dhe kontabile për shoqëritë dhe studiot profesionale dhe aktivitetet që kanë lidhje edhe indirekte me to, duke përfshirë por pa kufizuar, dhënien me qira të kompjuterave, mobiljeve dhe makinerive për zyrë si dhe ofrimin e shërbimeve të sekretarisë.

Gjithashtu Shoqëria mund të kryej kërkime të tregut, të zhvillojë marka dhe patenta, organizojë rrjete tregtare, nënshkruajë kontrata agjencie, projektojë impiante dhe ofrojë, edhe indirekt asistencë teknike në lidhje me aktivitetet e mësipërme.

Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë, si dhe të japë garanci, fideiusionë, të marrë hua dhe ofrojë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tretëve. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Selia e Shoqërisë është në Rr. 13 Dhjetori, pranë Dhomës së Tregtisë e Industrisë, Shkodër, Shqipëri.

Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë, i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali me një vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lekë secila.

Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Z. Renis Tershana, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 23.09.1971, banues në Rruga e Elbasanit, Pallati Tershana, nr. 2, Tiranë, Shqipëri, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 15.000,00 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë, nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë Sh.A, dega Tiranë, në favor të shoqërisë në themelim e sipër "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k; e
- Shoqëria ALBA INVEST s.r.l., shoqëri e së drejtës italiane, themeluar më 5.10.2005, me seli në Via Rosmini, n. 125, Lavis (Trento), Itali, dhe regjistruar pranë Regjistratit të ndërmarrjeve të Trentos me nr. 01945420220, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 85.000,00 (tetëdhjetëepesëmijë) lekë, nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë Sh.A, dega Tiranë, në favor të shoqërisë në themelim e sipër "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k.

Sipas kontributit të mësipërm:

- Z. Renis Tershana, qytetar shqiptar, i përkasin 15 (pesëmbëdhjetë) pjesë, që i korrespondojnë 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- Shoqërisë ALBA INVEST s.r.l., shoqëri italiane, i përkasin 85 (tetëdhjetëepesëmijë) pjesë, që i korrespondojnë 85% (tetëdhjetëepesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Administrator i Vetëm i Shoqërisë është Z. Filippo Bugoloni, shtetas italian, lindur në Trento, 19.03.1973, banues në Lomaso (TN), Itali, me pasaportë.nr. 891349R.

Nga aktet e paraqitura nga kërkuesi pranë kësaj Gjykate, rezulton se kërkesa është e bazuar në ligj dhe prova dhe si e tillë duhet të pranohet.

#### PËR KËTO ARSYE

Meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuar në përputhje me Ligjin nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar", Ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare" dhe Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare"

#### VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës; dhe
- Regjistrimin në Regjistrin Tregtar të Rrethit Gjyqësor Tiranë të Shoqërisë "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k
- Selia e Shoqërisë është në Rr. 13 Dhjetori, pranë Dhomës së Tregtisë e Industrisë, Shkodër, Shqipëri.
- Administrator i Vetëm i Shoqërisë është Z. Filippo Bugoloni, shtetas italian, lindur në Trento, 19.03.1973, banues në Lomaso (TN), Itali, me pasaportë.nr. 891349R.

GJYQTARE

BLERINA MUÇA



**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"AR EUROPROJECTS" Sh.p.k.**



Sot më datë 27 Janar 2006,

- Z. Renis Tershana, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 23.09.1971, banues në Rruga e Elbasanit, Pallati Tershana, nr. 2, Tiranë, Shqipëri, ligjërishit i përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nr. 4701 Rep., e nr. 2950 Kol, datë 17.10.2005, hartuar përpara Noteres Eriketa Kokoli, dhe lëshuar në favor të Av. Agim Muço, i pajisur me liçencë profesionale nr. 562; dhe
- Shoqëria ALBA INVEST s.r.l., shoqëri e së drejtës italiane, themeluar më 5.10.2005, me seli në Via Rosmini, n. 125, Lavis (Trento), Itali, dhe regjistruar pranë Regjistratit të ndërmarrjeve të Trentos me nr. 01945420220, ligjërishit e përfaqësuar nga Z. Mario Bugoloni, qytetar italian, lindur në Fiave', Itali, më 30.12.1946, banues në në Lomaso, Itali, me pasaportë nr. E 175231

kanë vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në Rr. 13 Dhjetori, pranë Dhomes së Tregëtisë dhe Industrisë Shkodër, Shqipëri.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë deri më datë 31.12.2050.

**Neni 4 – Objekti i shoqërisë**

4.1 Shoqëria "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

- aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje me pasuritë e paluajtëshme, si për llogari të vet ashtu edhe për llogari të enteve publike dhe private, si edhe ndërtimin, restaurimin, riparimin, shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhënie me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të paluajtëshme të veta, të të tretëve ose të dhëna me qera financiare, tregtare ashtu edhe industriale, edhe të mobiluara, lidhja e kontratave të sipërmarrjes sidhe zhvillimi i të gjitha aktiviteteve të lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje me pasuritë e paluajtëshme në përgjithësi përfshirë aktivitetin e ndërmjetësimit në lidhje me pasuritë e paluajtëshme;
- aktivitetin në lidhje me pjesëmarrjen në shoqëri dhe/ose ente të çfardo lloji, me përjashtim të atyre publike, sidhe aktivitetin për koordinimin teknik dhe financiar të shoqërive pjesëmarrëse;
- aktivitetin tregtar, për llogari të vet dhe/ose të të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes së përfaqësimeve dhe/ose mandateve të agjensisë, në Itali dhe



jashtë saj, të produkteve dhe pajisjeve për ndërtim, materialeve porfirike dhe derivateve të tyre, përfshirë gurin natyror, materialet inerte, përzierjet me përbërje bitumi, beton të ambalazhuar, materiale ndërtimi dhe makineri për ndërtim si dhe çdo gjë tjetër e lidhur direkt ose indirekt edhe me përdorimin e tyre;

- aktivitetin tregtar, për llogari të vet dhe/ose të të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes së përfaqësimeve dhe/ose mandateve të agjensisë, në Itali dhe jashtë saj, të mobiljeve dhe orëdivave të brëndshme në përgjithësi, si dhe me porosi, përfshirë projektimin dhe realizimin e tyre;

- aktivitetin e përpunimit dhe menaxhimit të të dhënave në përgjithësi, që nënkupton thjesht manipulimin informatik të tyre, si dhe aktivitetin e asistencës dhe ofrimin e shërbimeve administrative dhe kontabile për shoqëritë dhe studiot profesionale dhe aktivitetet që kanë lidhje edhe indirekte me to, duke përfshirë por pa kufizuar, dhënien me qira të kompjuterave, mobiljeve dhe makinerive për zyrë si dhe ofrimin e shërbimeve të sekretarisë.

4.2 Gjithashtu Shoqëria mund të kryej kërkime të tregut, të zhvillojë marka dhe patenta, organizojë rrjete tregtare, nënshkruajë kontrata agjensie, projektojë impiante dhe ofrojë, edhe indirekt asistencë teknike në lidhje me aktivitetet e mësipërme.

4.3 Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelimin e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë, si dhe të japë garanci, fideiusione, të marrë hua dhe ofrojë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tretëve. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

#### Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind) pjesë, të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera, me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë secila.

#### Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Z. Renis Tershana, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 23.09.1971, banues në Rruga e Elbasanit, Pallati Tershana, nr. 2, Tiranë, Shqipëri, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me lekë 15.000,00 (pesëmbëdhjetëmijë), nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë Sh.A, dega Tiranë, në favor të shoqërisë në themelimin e sipër "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k; dhe
- Shoqëria ALBA INVEST s.r.l, shoqëri e së drejtës italiane, themeluar më 5.10.2005, me seli në Via Rosmini, n. 125, Lavis (Trento), Itali, dhe regjistruar pranë Regjistrimit të ndërmarrjeve të Trentos me nr. 01945420220, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me lekë 85.000,00 (tetëdhjetëepesëmijë), nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë Sh.A, dega Tiranë, në favor të shoqërisë në themelimin e sipër "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k.

6.2. Sipas kontributit të mësipërm:

- Z. Renis Tershana, qytetar shqiptar, i përkasin 15 (pesëmbëdhjetë) pjesë, që i korrespondojnë 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- Shoqërisë ALBA INVEST s.r.l., shoqëri italiane, i përkasin 85 (tetëdhjetëpesë) pjesë, që i korrespondojnë 85% (tetëdhjetëpesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

#### Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

#### Neni 8 – Administratori

8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Vetëm i Shoqërisë personi i mëposhtëm:

- Z. Filippa Bugoloni, shtetas italian, lindur në Trento (TN), Itali, më datë 19.03.1973, banues në Lomaso (TN), Itali, me pasaportë nr. 891349R i cili ka të drejtë të ushtrisë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 50 të ligjit nr. 7638, datë 19 nëntor 1992 “Për shoqëritë tregtare”, dhe në përputhje me aktet apo veprimet që duhet të autorizohen paraprakisht nga Asambleja e Ortakëve.

8.2 Administratorit të Vetëm i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të formalitetet e përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori i Vetëm, mund t'i drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t'i delegojë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.3 Administratori i Vetëm është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor - Tiranë. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj pranë kësaj Gjykate si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

#### Neni 9– Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën italiane.

9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në italisht do të jetë i vetmi version ligjërishet detyrues.

\*\*\*\*\*

Lexuar, kuptuar dhe nënshkruar


Tiranë, më 27 Janar 2006


për Z. Renis Tershana

për ALBA INVEST s.r.l.

Av. Agim Muço

Z. Mario Bugoloni



  
MARIO BUGOLONI

**STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“AR EUROPROJECTS” Sh.p.k.**



**KAPITULLI I  
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Shoqëria “AR EUROPROJECTS” Sh.p.k. (në vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është “AR EUROPROJECTS” Sh.p.k.

**Neni 3 – Objekti i shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria “AR EUROPROJECTS” Sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:
  - aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje me pasuritë e paluajtëshme, si për llogari të vet ashtu edhe për llogari të enteve publike dhe private, si edhe ndërtimin, restaurimin, riparimin, shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhënie me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të paluajtëshme të veta, të të tretëve ose të dhëna me qera financiare, tregtare ashtu edhe industriale, edhe të mobiluara, lidhja e kontratave të sipërmarrjes sidhe zhvillimi i të gjitha aktiviteteve të lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje me pasuritë e paluajtëshme në përgjithësi përfshirë aktivitetin e ndërmjetësimit në lidhje me pasuritë e paluajtëshme;
  - aktivitetin në lidhje me pjesëmarrjen në shoqëri dhe/ose ente të çfardo lloji, me përjashtim të atyre publike, sidhe aktivitetin për koordinimin teknik dhe financiar të shoqërive pjesëmarrëse;
  - aktivitetin tregtar, për llogari të vet dhe/ose të të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes së përfaqësimeve dhe/ose mandateve të agjencisë, në Itali dhe jashtë saj, të produkteve dhe pajisjeve për ndërtim, materialeve porfirike dhe derivateve të tyre, përfshirë gurin natyror, materialet inerte, përzierjet me përbërje bitumi, beton të ambalazhuar, materiale ndërtimi dhe makineri për ndërtim si dhe çdo gjë tjetër e lidhur direkt ose indirekt edhe me përdorimin e tyre;
  - aktivitetin tregtar, për llogari të vet dhe/ose të të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes së përfaqësimeve dhe/ose mandateve të agjencisë, në Itali



dhe jashtë saj, të mobiljeve dhe orendive të brëndshme në përgjithësi, si dhe me porosi, përfshirë projektimin dhe realizimin e tyre;

aktivitetin e përpunimit dhe menaxhimit të të dhënave në përgjithësi, që nënkupton thjesht manipulimin informatik të tyre, si dhe aktivitetin e asistencës dhe ofrimin e shërbimeve administrative dhe kontabile për shoqëritë dhe studiot profesionale dhe aktivitetet që kanë lidhje edhe indirekte me to, duke përfshirë por pa kufizuar, dhënien me qira të kompjuterave, mobiljeve dhe makinerive për zyrë si dhe ofrimin e shërbimeve të sekretarisë.

- 3.2 Gjithashtu Shoqëria mund të kryej kërkime të tregut, të zhvillojë marka dhe patenta, organizojë rrjete tregtare, nënshkruajë kontrata agjensie, projektojë impiante dhe ofrojë, edhe indirekt asistencë teknike në lidhje me aktivitetet e mësipërme.
- 3.3 Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelimin e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë, si dhe të japë garanci, fideiusionë, të marrë hua dhe ofrojë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tretëve. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

#### **Neni 4 – Selia**

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në Rr. 13 Dhjetori, pranë Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë Shkodër, Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë deri më 31.12.2050.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT**

#### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë.



- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind) pjesë, të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera, me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë secila.

### Neni 7 - Kontributet

- 7.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- Z. Renis Tershana, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 23.09.1971, banues në Rruga e Elbasanit, Pallati Tershana, nr. 2, Tiranë, Shqipëri, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me lekë 15.000,00 (pesëmbëdhjetëmijë), nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë Sh.A, dega Tiranë, në favor të shoqërisë në themelimin e sipër "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k; dhe
  - Shoqëria ALBA INVEST s.r.l., shoqëri e së drejtës italiane, themeluar më 5.10.2005, me seli në Via Rosmini, n. 125, Lavis (Trento), Itali, dhe regjistruar pranë Regjistrimit të ndërmarrjeve të Trentos me nr. 01945420220, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me lekë 85.000,00 (tetëdhjetëepesëmijë), nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë Sh.A, dega Tiranë, në favor të shoqërisë në themelimin e sipër "AR EUROPROJECTS" Sh.p.k.
- 7.2. Sipas kontributit të mësipërm:
- Z. Renis Tershana, qytetar shqiptar, i përkasin 15 (pesëmbëdhjetë) pjesë, që i korrespondojnë 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
  - Shoqërisë ALBA INVEST s.r.l., shoqëri italiane, i përkasin 85 (tetëdhjetëepesë) pjesë, që i korrespondojnë 85% (tetëdhjetëepesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

### Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive.

### Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, me votën pro të ortakëve që zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e kapitalit themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

### Neni 10 – Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 10.1 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi të pjesëve të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar më sipër, si me shpërbllim ashtu edhe pa shpërbllim,



*[Handwritten signatures]*

me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto pjesë kapitali.

- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë pjesët e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesët e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, pjesët e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë më pjesët që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë që përfaqëson të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katrat) e kapitalit themeltar, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 7638, datë 19 nëntor 1992 "Për shoqëritë tregtare".
- 10.7 Pjesët e kapitalit të Shoqërisë janë lirish të transferueshme për shkak trashëgimie *mortis causa*. Në rast të vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut të vdekur, trashëgimtarët duhet të emërojnë një përfaqësues të përbashkët.
- 10.8 Në rast të transferimit të pjesëve të kapitalit për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj sipas modaliteteve të parashikuara në nenin 46 të ligjit nr. 7638, datë 19 nëntor 1992 "Për shoqëritë tregtare".

### KAPITULLI III


#### ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

##### Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Vendimet e Asamblesë duhet të miratohen, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në atë vijuese, nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetënjë për qind) të të gjithë kapitalit themeltar. Vendimet janë të detyrueshme për ortakët që nuk janë të pranishëm ose që nuk janë dakord, përveç së drejtës së tyre të kundërshtimit që ushtrohet në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.

##### Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i pjesëve të kapitalit që ai zotëron.





- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

### Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël sidhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga eksperti kontabël (nëse është i emëruar), ose nga likuidatori/likuidatorët sidhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.
- 13.3 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.4 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Itali ose në Shqipëri.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'i lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Asambleja vendos mbi ndryshimet në Statut me votën *pro* të ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
- 13.8 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.9 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

### Neni 14 – Administrimi



14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator dhe maksimumi 5 (pesë), të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen ose deri në afatin e caktuar nga Asambleja në aktin e emërimit.

Gjithësesi do të jetë i nevojshëm autorizimi paraprak i ortakëve, me vendim që do të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të shoqërisë, për përmbushjen e akteve në vijim:

- Marrja e kredive, garancive dhe hapja e kredive në përgjithësi pranë çdo instituti ose ndërmarrje kredie, me ose pa garanci me një vlerë më të madhe se 300.000,00 (treqind mijë presje zero) Euro ose vlerë të njëjtë në monedhë tjetër;
- Shitblerja, kontributet dhe dhënia me qira e ndërmarjes ose degëve të ndërmarrjes;
- Themelimi i shoqërive të çdo tipi, Konsorciumeve dhe enteve kolektive të çdo tipi;
- Blerja, shitja dhe dhënia me qira e pasurive të luajtëshme të regjistruara;
- Çdo operacion që tejkalon vlerën prej 300.000,00 (treqind mijë presje zero) Euro ose vlerë të njëjtë në monedhë tjetër i konsideruar veçmas ose i ndar në fraksione dhe që ka të bëjë me të njëjtën marrëveshje.

14.3 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorëve, bashkarisht apo veçmas, në përputhje me nenin e mëposhtëm 14.6.

14.4 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

14.5 Administratorëve mund t'i jipet një shpërblim vjetor, edhe si pjesëmarrje në fitime, e cila duhet të përcaktohet me vendim të Asamblesë.

14.6 Asambleja e Ortakëve apo Akti i Themelimit të Shoqërisë mund t'i delegojë njërit apo disa prej Administratorëve, edhe atyre të emëruar në momentin e themelimit të shoqërisë, të drejtën për të ushtruar të vetëm kompetencat e parashikuara nga nenin 50, i ligjit nr. 7638, datë 19 shtator 1992 "Për shoqëritë tregtare".

#### **Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar**

15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, emëruar për 6 (gjashtë) vjet.

15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

### **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**

16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë më tepër se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

#### Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos t'i vërë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

### KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

#### Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

#### Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operationet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

### Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen një gjykate shqiptare, përveç kur një nga ortakët vendos të kërkojë procedurën e arbitrazhit. Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga aq arbitra sa palë ka çështja, plus një që do të ketë funksionin e Kryetarit. Secili ortak do të emërojë një arbitër, ndërsa Kryetari do të emërohet me marrëveshje midis arbitrave të emëruar, ose në rast mosmarrëveshjeje, nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 30 ditësh nga kërkesa e bërë nga pala më e interesuar. Megjithatë, para krijimit të Gjykatës së Arbitrazhit, secila palë mund t'i kërkojë gjykatës së Tiranës miratimin e masave parandaluese dhe urgjente. Këto masa duhet të konfirmohen ose të revokohen nga Gjykata e e Arbitrazhit pas krijimit të tij. Në rast se zgjidhja e mosmarrëveshjeve duhet t'i besohet një gjykate shqiptare, kompetenca ekskluzive i takon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 20.3 Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë me drejtësi dhe do të depozitojë vendimin arbitror brenda 90 ditësh nga data e pranimit të detyrës nga abritri i tretë. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit është i paapelueshëm.
- 20.4 Vota e Kryetarit të Gjykatës së Arbitrazhit do të jetë vendimtare në rast barazie votash brenda Kolegjit.
- 20.5 Vendi i arbitrazhit do të jetë Tirana. Gjuha e arbitrazhit do të jetë shqipja.

### Neni 21 – Gjuha

- 21.1 Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën italiane.
- 21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në italisht do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërishit detyrues.

\*\*\*\*\*

Lexuar, kuptuar dhe nënshkruar



Tiranë, më 27 Janar 2006

për Z. Renis Tershana

për ALBA INVEST s.r.l.

Av. Agim Muço

Z. Mario Bugoloni

MARIO BUGOLONI

Logo  
Patrizia Pagano  
Notere  
Via Matteotti, 63  
38015 Lavis (TN)  
Tel 0461 241731  
Fax 0461 241732  
Email notaio@notaiopagano.it

Rep. n. 27/2013



Kol. n. 4104

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

REPUBLIKA ITALIANE

Më 5 tetor dymijë e pesë.

Në Lavis dhe në zyrën time.

Përpara meje Dok. Patrizia PAGANO Noter në Lavis me studio të tyre në Via Matteotti nr. 63, regjistruar në Dhomën e Noterëve të Rretheve të Bashkuar të Trento-s e Rovereto-s, pa pranin e dëshmitarëve prej të cilëve palët heqin dorë me miratimin tim.

Janë të pranishëm:

Shoqëria "CALIARI GIUSEPPE & C. S.N.C." me seli ne Bleggio Inferiore në pjesën Cares nr. 119, kapitali i shoqërisë 20.658,28 (njëzetmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë presje njëzetetetë) Euro, kodi fiskal dhe numri i regjistrimit pranë Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Trento-s 01099500223, në emër të Administratorit Ortak dhe përfaqësuesit Ligjor Gianfranco CALIARI, sipërmarrës, lindur në Bleggio Inferiore më 12 mars 1960 dhe banues po aty në pjesën Cares nr. 89, vendosur si banues për të kryer detyrën pranë selisë së shoqërisë, i autorizuar në këtë akt në cilësinë e

kompetencave që i janë dhënë nga marrëveshjet e shoqërisë, shoqëri e krijuar në Itali me akt të noterizuar nga Noteri Luigi Maria D'Argenio nga Riva del Garda më datë 20 shtator 1985 Rep. nr. 20889 regjistruar në Riva del Garda më datë 20 shtator 1985 në nr. 2087 Mod. 1° Vol. 40;

Patrick CLEMENTI, sipërmarrës, lindur në Bolzano më 18 nëntor 1975 është banues në Egna, pjesa Laghetti, në Via Nazionale n. 2/1, kodi fiskal i deklaruar CLM PRC 75S18 A9520, qytetar italian;

Michele MOSER, tregtar, lindur në Trento më 23 shtator 1964 dhe banues në Lavis në Via Rosmini n. 56, kodi fiskal i deklaruar MSR MHL 64P23 L378D, qytetar shqiptar;

Mario BUGOLONI, sipërmarrës, lindur në Fiavè më 30 dhjetor 1946 dhe banuese në Lomaso, pjesa Godenzo nr. 42, kodi fiskal i deklaruar BGL MRA 46T30 D565U, qytetar italian;

Gjon RADOVANI, sipërmarrës, lindur në Shkodër, më 8 mars 1961 dhe banues në Stoccarda në Ludëigstrasse n. 9 (Germania), qytetar gjerman.

Themeluesit, për identitetin, aftësitë dhe kompetencat e të cilëve unë Noteri jam e sigurtë

BIEN DAKORT

Neni 1

Shoqëria "CALIARI GIUSEPPE & C. S.N.C." dhe zotërinjtë Patrick CLEMENTI, Michele MOSER, Mario BUGOLONI dhe Gjon RADOVANI

THEMELOJNË



Një shoqëri më përgjegjësi të kufizuar si më poshtë:

EMËRTIMI: "ALBA INVEST Sh.p.k.";

SELIA: Shoqëria ka seli në Komunën e Lavis.


Mësoi për regjistrimin e Shoqërisë në regjistrin e Ndërmarrjeve kompetente  
palet përgojnë adresën e shoqërisë në Via Rosmini n. 125.

KOHEZGJATJA: 31 dhjetor 2030.

OBJEKT:

Shoqëria ka për objekt aktivitetet e mëposhtme:

- aktiviteti ndërtimi dhe imobiliare, si për llogari të tyre ashtu edhe për llogari të enteve publike dhe private, si edhe ndërtimin, restaurimin, përmirësimin, shkëmbimin, blerjen, shitjen, qiramarrjen, drejtimin, administrimin e pasurive të tyre të paluajtshme, të të tretëve ose ne qira financiare, si civile, tregtare dhe industriale, edhe të mobiluara, lidhjen e kontratave të sipërmarrjes si dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura drejtpërdrejt ose indirekt me aktivitetin e ndërtimit dhe pasuritë e paluajtshme në përgjithësi, me përjashtim të aktivitetit të ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme;
- aktivitetin e marrjes përsipër të pjesëmarrjeve dhe interesave në shoqëri dhe/ose enteve të çfarëdo lloji me kusht që të mos jetë në drejtim të publikut si dhe kordinimit teknik dhe financiar të shoqërive pjesëmarrëse;
- aktivitet tregtar, për llogari të vetë dhe/ose të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes përsipër të përfaqësimeve dhe/ose mandateve të



agjencive, në Itali dhe jashtë saj të produkteve dhe pajisjeve për ndërtim, materiale përiri dhe derivate të saj, duke përfshirë dhe gur natyral, materiale, beton bituminoz, beton i gatshëm (preconfeksionuar), materiale ndërtimi dhe makina për ndërtimin dhe çfarëdo tjetër drejtpërdrejtë ose indirekt i lidhur me të si dhe zbatimin e tyre;

- aktivitetin e tregtisë, për llogari të vetë dhe /ose të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet sipërmarrjes së përfaqësive dhe/ose mandateve të agjencive, në Itali dhe jashtë saj të mobiljeve dhe mobilim i brëndshëm në përgjithësi, edhe me porosi duke përfshirë projektimin dhe zbatimin;

- aktivitetin e trajtimit dhe menaxhimit të të dhënave në përgjithësi, në sensin e trajtimit informatike të tyre, si dhe aktivitet asistence dhe dhënie shërbimesh administrative dhe kontabile shoqërive dhe studiove profesionale dhe aktivitete të lidhura edhe indirekt me aktivitetet e lartpërmendura, si shembull por pa u kufizuar në to, qiradhënie kompjuterash, të luajtshme dhe aparatura për zyrë si dhe furnizim me shërbime sekretarie.

Shoqëria mund të zhvillojë të gjitha aktivitetet e tjera tregtare , industriale, financiare, me pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme që do konsiderohen nga organi administrativ si mjete, aksesori, lidhje, të nevojshme ose të dobishme për realizimin e aktivitetit që përbëjnë objektin e shoqërisë, të marrë përsipër interesime dhe pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose ndërmarrje që kanë për objekt aktivitet analog me të, të ngjashëm

ose të lidhura me aktivitetin e tyre, si drejtpërdrejt, në Itali edhe jashtë saj, si dhe të lëshojë garanci dhe dorëzani në favor të ortakëve ose të tretëve, me qëllim që të mos jetë në drejtim të publikut, si dhe ndërtojë ose të marrë pjesë në krijimin shoqëri sipërmarrëse të përkohshme ose të lidhë cotrata të shoqatave në pjesëmarrje, dhe me kusht që të tilla aktivitete të mos zhvillohen në masë mbizotëruese në lidhje me ata që krijojnë objektin e shoqërisë.

Përfundohet shprehimisht çdo aktivitet që bën pjesë në të drejtat që e kanë të nevojshme regjistrimin në Regjistra Profesionalë dhe çdo aktivitet financiar përjashtuar nga ligji që hyn në fuqi here pas here në këtë fushë dhe në veçanti sipas asaj që është vendosur nga neni 113 i Dekretit Legjislativ nr. 385, datë 1 shtator 1993.

Shoqëria ndalon mbledhjen e kursimeve midis publikut dhe aktiviteteve të parashikuara nga Dekreti Legjislativ Nr 415/96.

Kapitali i Shoqërisë është 30.000,00 Euro (tridhjetëmijë presje zero).

Shpenzimet e Krijimit: 4.000,00 Euro (katër mijë presje zero)

Neni 2

Kapitali i shoqërisë prej 30.000,00 Euro (tridhjetë mijë presje zero)

nënshkruhet nga ortakët:

ORTAKU	KUOTA
"CALIARI GIUSEPPE & C. S.N.C."	6.000,00 Euro;
Michele MOSER	6.000,00 Euro;

Patrick CLEMENTI 6.000,00 Euro;

Mario BUGOLONI 6.000,00 Euro;

Gjon RADOVANI 6.000,00 Euro.

Pranë "CASSA RURALE LAVIS - VALEL DI CEMBRA - B.B.C. më datë 5 tetor 2005, siç rezulton nga mandati në kopje e vërtetuar me akt noterial nga ana ime në datën e sotme Repertor nr. 27572 që i bashkëngjitet gërmës "A", është derdhur 25% (njëzetepesë për qind) e kapitalit të shoqërisë e barabartë me 7.500,00 Euro (shtatë mijë e pesëqind presje zero).

Ortakët deklarojnë që pjesa që mbetet prej 75 % (shtatëdhjetë e pesë për qind) do të derdhet me kërkesë të Organit Administrativ.

Neni 3

Administrimi i shoqërisë i besohet një Administratori të vetëm, emëruar me kohë të papërcaktuar deri në revokim ose dorëheqje, është zgjedhur Mario Bugoloni i cili ka të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administrimit, duke përjashtuar ato që ligji ose statuti i rezervon shprehimisht ortakëve.

Megjithatë do të jetë i nevojshëm një autorizim paraprak i ortakëve, me vendim për tu përshtatur me votë favorevole të shumë ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 95% (nëntëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë, për përmbushjen e akteve të mëposhtme:

- marrja e huave, kredive dhe hapje kredish në përgjithësi pranë instituteve dhe ndërmarrjeve të kredive, me ose pa garanci të shumave mbi 1.000.000,00 Euro (një milion presje zero);

- shitja, dhënia dhe marrja me qera e ndërmarrjeve ose degëve të ndërmarrjeve;

- krijimi i shoqërive të çdo tipi, Konsorcium dhe enteve kolektive të çdo lloji;

- blerja dhe kalimi i pjesëmarrjeve dhe interesime të çdo lloj tipi;

- çdo veprim me pasuri të paluajtshme, duke përfshirë dhe krijimin dhe tjetërsimin e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, që kalojnë shumën prej 1.000.000,00 Euro (një milion presje zero) e marrë veçanarisht ose nëse ndahet të jetë e kthyeshme në një shumë të vetme.

Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i takon Administratorit.

Zoti Mario BUGOLONI pranon detyrën, kërkon, sipas nenit 2383, paragrafi IV, të Kodit Civil regjistrimin e emërtimit të tij në Regjistrin e Ndërmarrjeve dhe deklaron se në ngarkim të tij nuk ekziston asnjë nga çështjet e pazgjithshme ose rënie të parashikuara nga neni 2382 i kodit civil ose nga norma të tjera dhe heq dorë paraprakisht dhe shprehimisht nga dëmshpërblimi i dëmit në rast të revokimit nga mandati përpara mbarimit të tij, duke u shmangur paragrafit të tretë të nenit 2383 të kodit civil.

Delegon Noterin Patrizia Pagano që të përfundojë zbatimin e tij.

Neni 4

Viti ushtrimor i shoqërisë mbyllet më datë 31 dhjetor të çdo viti.

Viti i parë ushtrimor mbyllet më datë 31 dhjetor 2006.

Neni 5

Nga të ardhurat neto që rezultojnë nga bilanci duhet të zbritet një shumë korresponduese më 5% (pesë për qind) të destinuara për reserve ligjore derisa kjo të mos ketë arritur një të pestën e kapitalit të shoqërisë.

Vendimi i ortakëve që miraton bilancin vendos mbi shpërndarjen e të ardhurave.

Mund të shpërndahen ekskluzivisht të ardhurat që vijnë realisht dhe rezultojnë nga bilanci i miratuar rregullisht, duke zbritur kuotën e destinuar për rezervë ligjore.

Nëse verifikohet një humbje e kapitalit të shoqërisë, nuk ka vend për shpërndarje të të ardhurave derisa kapitali të jetë rimëkëmbur ose pakësuar në masë proporcionale.

Nuk lejohet shpërndarja e paradhënieve mbi të ardhurat.

Neni 6

Zoti Mario BUGOLONI i është deleguar të tërheqi 25% (njëzetepesë për qind) të kapitalit të shoqërisë së derdhur.

Shpenzimet e këtij akti dhe si rrjedhojë janë në ngarkim të Shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë rregullohen nga normat si më poshtë:

#### **STATUTI I SHOQËRISË**

Neni 1) Themelimi

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "ALBA INVEST S.R.L."

Neni 2) Selia

2.1 Shoqëria ka selinë në Komunën e Lavis.

2.2 Kërkimi administrativ ka aftësinë të transferojë selinë e shoqërisë rreth Komunës së treguar më sipër në pikën 2.1; asamblesë së ortakëve i takon të vendosë transferimin e selisë në Vend tjetër edhe Jashtë vendit.

Neni 3) Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt aktivitetet e mëposhtme:

- aktivitet ndërtimor dhe pasuri të paluajtshme, si për llogari të vetë edhe për llogari të enteve publike dhe private, si dhe ndërtimin, restaurimin, përmirësimin, shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhënie me qera, drejtimin, administrimin e pasurive të paluajtshme të veta, të tretëve ose në qera financiare, si civile, tregtare dhe industriale, edhe të mobiluara, lidhja e kontratave të sipërmarrjes si dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të lidhura direkt ose indirekt e aktivitetin e ndërtimit dhe të pasurive të paluajtshme në përgjithësi, me përjashtim të aktivitetit të ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme;
- aktivitetin e marrjes përsipër të pjesëmarrjeve dhe interesave në shoqëri dhe/ose enteve të çfarëdo lloji me kusht që të mos jetë në drejtim të publikut si dhe kordinimit teknik dhe financiar të shoqërive pjesëmarrëse;

- aktivitet tregtar, për llogari të vetë dhe/ose të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes përsipër të përfaqësimeve dhe/ose mandateve të agjencive, në Itali dhe jashtë saj të produkteve dhe pajisjeve për ndërtim, materiale portland dhe derivate të saj, duke përfshirë dhe gur natyral, materiale të forta, beton bituminoz, beton i gatshëm (prekonfeksionuar), materiale ndërtimi dhe makina për ndërtimin dhe çdo gjë tjetër drejtpërdrejtë ose indirekt të lidhur me të si dhe zbatimin e tyre;

aktiviteti i tregtisë, për llogari të vetë dhe /ose të të tretëve, me shumicë dhe pakicë, nëpërmjet marrjes përsipër të përfaqësive dhe/ose mandate të agjencive, në Italia dhe jashtë saj të mobiljeve dhe mobilim i brendshëm në përgjithësi, edhe me masë duke përfshirë projektimin dhe zbatimin;

- aktivitetin e hartimit dhe drejtimit të të dhënave në përgjithësi, në sensin e trajtimit informatike të tyre, si dhe aktivitet të asistencës dhe dhënie shërbimesh administrative dhe kontabile shoqërive dhe studiove profesionale dhe aktivitete të lidhura edhe indirekt me aktivitetet e lartpërmendura, si shembull por pa u kufizuar në to, qiradhënie kompjuterash, të luajdashme dhe aparatura për zyrë si dhe dhënie shërbimesh sekretarie.

Shoqëria mund të zhvillojë të gjitha aktivitetet e tjera tregtare , industriale, financiare, me pasuritë e luajdashme dhe të paluajdashme që do konsiderohen nga organi administrativ si mjete, aksesori, lidhje, të



nevojshme ose të dobishme për realizimin e aktivitetit që përbëjnë objektin e shoqërisë, të marrë përsipër interesime dhe pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose ndërmarrje që kanë për objekt aktivitet analog me të, të ngjashëm ose të lidhura aktivitetin e tyre, si drejtpërdrejt, si në Itali edhe jashtë saj, si dhe të lëshojë garanci dhe dorëzani në favor të ortakëve ose të tretëve, me kusht që të mos jetë në drejtim të publikut, si dhe ndërtojë ose të marrë pjesë në krijimin shoqëri sipërmarrëse të përkohshme ose të lidhë kontrata të shoqatave në pjesëmarrje, dhe me kusht që të tilla aktivitete të mos zhvillohen në masë mbizotëruese në lidhje të atyre që krijojnë objektin e shoqërisë.

Përfshihen gjithashtu çdo aktivitet që bën pjesë në të drejtat që e kanë të nevojshme regjistrimin në Regjistra Profesional dhe çdo aktivitet financiar përjashtuar nga ligji që hyn në fuqi here pas here në këtë fushë dhe në veçanti sipas asaj që është vendosur nga neni 113 i Dekretit Legjislativ nr. 385, datë 1 shtator 1993.

Shoqëria ndalon mbledhjen e kursimeve midis publikut dhe aktiviteteve të parashikuara nga Dekreti Legjislativ Nr 415/96.

#### Neni 4) Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur deri më 31 dhjetor 2030 dhe mund të zgjatet ose të shkrihet paraprakisht në zbatim të ligjit ose statutit.

#### Neni 5) kapitali

Kapitali është fiksuar për 30.000,00 Euro (tridhjetëmijë presje zero zero).

5.1 Kapitali mund të rritet nëpërmjet dhënie në para ose natyrë ose nëpërmjet kalimit të rezervave të disponueshme për kapitalin.

5.2 Rritja e kapitalit kryhet me vendim të asamblesë së ortakëve me votën pro të shumicën së parashikuar për ndryshimin e këtij akti themelimi.

5.3. Administratorëve nuk i është dhënë aftësia për të rritur kapitalin sipas nenit 2481 të kodit civil.

5.4 Në rast vendimi për rritjen e kapitalit nëpërmjet dhënies të reja i takon ortakëve e drejta për ta nënshkruar në proporzion më pjesëmarrjet e zotëruar prej tyre. Me përjashtim të rastit sipas nenit 2481 të kodit civil, ortakëve i është dhënë aftësia të parashikojnë shprehimisht në vendimin e rritjes, ku vendimi mund të zbatohet edhe nëpërmjet ofertës së kuotave të emëtimit të reja të tretëve; në këtë rast i takon ortakëve që nuk kanë pranuar vendimin e drejta e prapësimir sipas normave të nenit 27 pasues.

5.5 Mund të jepen si kontribut për rritjen e kapitalit, të gjitha elementët e aktivitetit të ndryshueshëm nga vlerësimi ekonomik, duke përfshirë punën individuale ose të shërbimeve në favor të shoqërisë; vendosja e rritjes së kapitalit duhet të vendosë menyrat e dhënies: në mungesë të çfarëdolloj treguesi dhënia duhet të bëhet në para.

5.6 Dhënia mund të kryhet nëpërmjet dhënies së një police sigurimi ose të një dorëzanie bankare me të cilat garantoohen, për të gjithë shumën që është dorëzuar prej tyre, detyrimet e marra nga ortaku që kanë për objekt dhënien e veprave ose shërbimeve në favor të shoqërisë. Në këtë rast polica ose

dorëzania mund të zëvendësohen nga ortaku me derdhjen e një capare me të njëjtën vlerë në para pranë shoqërisë.

5.7 Në rast të një rritje pa pagesë kuota e pjesëmarrjes të secilit ortak qëndron e pandryshuar.

#### Neni 6. Zvogëlimi i kapitalit

6.1 Kapitali mund të pakësohet në rastet dhe me mënyrat e ligjit nëpërmjet vendimit të Asamblesë të ortakëve për tu përshtatur me shumicat e parashikuara nga ndryshimi i këtij akt themelimi, përveç sa është vendosur nga neni 33 pasues.

6.2 Në rast të pakësimit të kapitalit për shkak të humbjeve, mund të kapërcehet depozitimi mbrojtës pranë selisë së shoqërisë, të paktën tetë ditë përpara asamblesë, të raportit të organit administrativ mbi situatën pasurore të shoqërisë dhe vëzhgimeve të Kolegjit të Ekspertëve Kontabël ose revisorëve, nëse janë emëruar, kur ekziston konsensusi unanimit të gjithë ortakëve. Heqja dorë nga depozitimi si më lart duhet të konfirmohet nga asambleja dhe duhet të rezultojë nga procesi verbal i përkatës.

#### Neni 7 Financimet e ortakëve

7.1. Ortakët mund të zbatojnë, me kërkesë të organit administrativ dhe në mbështetje të dispozitave në fuqi të karakterit fiskal, derdhje në llogari të kapitalit ose financime që normalisht nuk japin interesa përveç ndonjë vendimi tjetër të ortakëve i marrë në bazë të nenit 11, që nuk krijojnë

mbledhje kursimesh midis publikut në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi në fushën bankare dhe kreditore.

7.2. Në rast të derdhjeve në llogari të kapitalit, shumat përkatëse mund të përdoren për mbulimin e humbjeve të mundshme ose të transferuara në drejtim të kontribues së kapitalit të cfarëdolloj shume, dhe kjo paraprakisht përputhet me vendimit që do merret në mbledhjen asambleare, përveç sa është vendosur në nenin 33.

7.3. Për rimbursimin e finacimeve të ortakëve aplikohet dispozita e nenit 2467 të kodit civil.

#### Neni. 8) Të drejtat e ortakëve

8.1 Të drejtat e ortakëve të shoqërisë u takojnë ortakëve në përpjestim me pjesmarrjen në çdo seancë.

8.2 Të drejtat si në pikën e mësipërme 8.1 mund të ndryshohen me vendim të asamblesë për tu marrë me pëlqimin unanimit të të gjithë ortakëve.

#### Neni. 9 Pjesmarrjet dhe transferimi i tyre

9.1 Në rastin e një bashkëpronësie të një pjesëmarrjeje, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët i emëruar sipas modaliteteve të parashikuara nga neni 1105 dhe 1106 Kodi Civil.

9.2 Në rastin e pengut, uzufuktit ose sekuestrimit të pjesëmarrjeve aplikohet neni 2352 i Kodit Civil.

9.3 Pjesëmarrjet janë lirisht të transferueshme me akt midis të gjallëve, ndërmjet ortakëve, ortakut dhe bashkëshortit ose të afërmeve të radhës së parë në linjë të drejtë ose të radhës së dytë në linjë të tërthortë.

Për transferimet me akt midis të gjallëve në favor të subjekteve të tjera të ndryshme nga ata të cituar në paragrafin më lart ortakëve të tjerë rregullisht të regjistruar në librin e ortakëve, sipas të drejtës së parablerjes për blerjen, sipas pikës 9.5. Në rast të mungesës së ushtrimit të parablerjes, lëshuesi duhet të marrë miratimin unanimit të ortakëve të tjerë, me qëllim që propozimi për transferim, i cili përmban gjeneralitetet e blerësit dhe përshkrimin e pjesmarrjes që do të transferohet, duhet tu komunikohet ortakëve të tjerë me letër rekomande, ortakët duhet të prononcohen nëpërmjet vendimit përkatës të marrë në bazë të nenit pasardhës 11 dhe me miratimin unanimit të të gjithë ortakëve të tjerë pa detyrim motivimi; vendimi i ortakëve duhet ti komunikohet ortakut transferues me letër rekomande brenda tridhjetë ditëve nga komunikimi i propozimit për transferimit; në mungesë të përgjigjes ose në mungesë të miratimit asambleja e ortakëve duhet të sigurojë brenda 30 ditëve një tjetër blerës, me vendim të ortakëve për tu mbledhur në asamble me votën pro të shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën 80% (tetëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë; me synimin e përcaktimit të shumicës nuk merret parasysh pjesmarrja e ortakut transferues. Me kalimin e një afati të tillë përfundimtar, miratimi do të konsiderohet i lejuar.


9.4 Për "trasferimet me akt midis të gjallëve" për qëllimet e aplikimit të këtij ligji kuptohen të gjithë dyqanet ushqimorë, në kuptimin më të gjerë të fjalës dhe përveç shitjes dhe vetëm si shembull, kontratat e shkëmbimit, kontributet e aksioneve dhe aktdhurime.

9.5 Për ushtrimin e të drejtës së parablerjes vlejné modalitetet dhe dispozitat e mëposhtme.

- ortaku që ka si qëllim të transferojë të gjithë ose pjesë të pjesëmarrjes së tij, në rastin kur në pikat e mëparshme 9.3 dhe 9.4, do të duhet të komunikojë ofertën e tij me cdo lloj mjeti që ofron provën e marrjes nga organi administrativ: oferta duhet të përmbajë gjeneralitetet e pritësit të së drejtës dhe kushtet e lëshimit, midis të cilave, në vecanti, çmimi, dhe modalitetet e pagimit. Organi administrativ, Brenda 15 ditëve të marrjes së komunikimit, transmeton me të njëjtat modalitete ofertën tek ortakët e tjerë, që duhet të ushtrojné të drejtën e parablerjes me modalitetet e mëposhtme:

a) cdo ortak I interesuar në blerje duhet të paraqesë në organin administrative deklaratën e ushtrimit të parablerjes me cdo lloj mjeti të mundshëm për të siguruar provën e marrjes brenda tridhjetë ditësh nga komunikimi I bërë nga organi administrativ.

b) Pjesëmarrja duhet të transferohet brenda tridhjetë ditësh nga data në të cilën organi administrativ do të ketë komunikuar ortakut ofrues - brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga skadenca e afatitit sipas pikës a) - pranimin e



ofertës duke treguar ortakët që pranojnë, të ndarjes midis tyre të pjesëmarrjes së ofruar (dhe mënyrat e mundshme për tu vëzhguar në rast se pjesëmarrja e ofruar nuk është proporcionalisht e ndarëshme midis të gjithë ortakëve që pranojnë), të datës së vendosur për transferimin.

Në hipotezën e ushtrimit të së drejtës të parablerjes nga ana e më shumë se një ortaku, pjesëmarrja e paraqitur do I takojë ortakëve të interesuar në përpjestim me pjesëmarrjen e secilit prej tyre të zotëruar.

Nëse ndokush prej ortakëve që të drejtën e parablerjes nuk mund ose nuk do ta ushtrojë, e drejta që i takon atij rritet automatikisht dhe proporcionalisht në favor të atyre ortakëve, që përkundrazi, kanë ndërmend ta vlerësojnë.

E drejta e parablerjes duhet të jetë ushtruar për të gjithë ofertën e pjesëmarrjes, sepse i tillë është objekti i pjesëmarrjes së formuluar nga ortaku ofrues.

Në rast se asnjë ortak nuk ka ndërmend të blejë pjesëmarrjen e ofruar në respektim të afateve dhe modaliteteve të sipërpërmendura, ortaku ofrues pasi ka marrë miratimin sipas dhe në zbatim të nenit 9.3, do të jetë I lirë të transferojë të gjithë pjesëmarrjen blerësit të treguar në komunikimin e bërë brenda gjashtëdhjetë ditëve në vazhdim, në mungesë të së cilës procedura e parablerjes do të përsëritet.

Parablerja duhet të ushtrohet për cmimin e treguar nga ofruesi. Në rast se cmimi i kërkuar konsiderohet I tepruar nga cilido prej ortakëve që kanë

manifestuar në afatet dhe format e përcaktuara më sipër vullnetin për të ushtruar parablerjen si dhe në të gjitha rastet në të cilat natyra e veprimtarisë nuk parashikon një kundërvlerë ose kundërvlera është e ndryshme nga një shumë të hollash, cmimi I lëshimit do të përcaktohet nga palët me miratimin e të gjithëve. Në rast se nuk do të arrihet asnjë mirëkuptim, cmimi do të jetë I përcaktuar, nëpërmjet një ekspertise të një eksperti të emëruar nga Presidenti I Gjykatës së Trentos me kërkesën e palës më të interesuar; në kryerjen e përcaktimit të tij , eksperti duhet të mbajë parasysh situatën patrimoniale të shoqërisë, të të ardhurave të saj, të vlerës së të mirave materiale dhe jomateriale zotëruara nga ajo të pozicionimit të saj në treg dhe të cdo rrethane dhe kushti që mbahet parasysh me qëllimin e përcaktimit të vlerës së pjesëmarrjes në shoqëri, me kujdes të vecantë dhe eventualisht një "cmim të shumicës" për rastin e transferimit të paketës së kontrollit të shoqërisë.

E drejta e parablerjes I takon ortakëve edhe kur mendohet të transferohet vetëm titulli i pronësisë së pjesëmarrjes.

E drejta e parablerjes nuk I takon për rastin e krijimit të pengut ose uzufruktit.

Në hipotezën e transferimit të pjesëmarrjes me akt midis të gjallëve i kryer pa zbatimin e sa më sipër përshkruar, blerësi nuk do të ketë të drejtë të regjistrohet në librin e ortakëve, nuk do të legjitimohet në ushtrimin e



votës dhe të të drejtave të tjera administrative dhe nuk mund të tjetërsojë pjesëmarrjen me efekt kundrejt shoqërisë.

Lëshimi i pjesëmarrjeve do të jetë i mundur pa zbatimin e formaliteteve kur ortakët lëshues ka marrë mospranimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes për atë lëshim special dhe miratimin nga ana e ortakëve të tjerë.

9.6 Regjistrimi i pronësisë në emër të shoqërive fiduciare ose reregjistrimi i pronësisë nga ana e po asaj (duke paraqitur më parë mandatin fiduciar) për pronarët efektiv nuk është subjekt i dispozitave të këtij neni.

#### Neni. 10 Trasferimet për shkak vdekje të pjesëmarrjeve

10.1 Pjesëmarrjet janë lirisht të transferueshme me trashëgimi për shkak vdekje. Në rast të vazhdimësisë së shoqërisë me më shumë trashëgimtarë të ortakut të vdekur, duhet të zgjedhin një përfaqësues të përbashkët.


Në rast të transferimit të kuotave me trashëgimi për shkak vdekje personve të ndryshëm nga bashkshorti, nga të afërm në linjë të drejtë dhe nga të afërm në degë anësore të shkallës së dytë, u lidhet ortakëve të tjerë e drejta e zgjedhjes për blerjen e kuotës nga përfituesit Brenda dhjetë muajsh nga transferimi i vlerësë që blihet e shitet të tregtisë së përbashkët të përcaktuar sipas nenit 28. nëse më shumë ortakë ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes blerja bëhet me kuotat e zotëruara.

#### Neni 11) Vendimi i ortakëve

Ortakët vendosin mbi materialin e rezervuar në kompetencat e tyre të ligjit nga ky akt kushtetues, për më tepër mbi argumentat që një ose më shumë

administratorë ose shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë të vendosura nën aprovimin e tyre.

11.1 Ndo rasti janë rezervuar në kompetencën e ortakëve:



a) aprovimi i bilancit dhe shpërndarjes së të ardhurave.

b) Emërimi i organit administrative;

c) emërimi i rasteve të parashikuar nga ligji i sindikatave dhe presidenti i kolegjit sindikal ose i revizorit.

d) modifikimet e këtij Statuti.

e) vendimi i përmbushjes së operacioneve që sjellin një modifikim thelbësor të objektit të shoqërisë ose një modifikim i konsiderueshëm i të drejtave të ortakëve.

nenit 2465 paragrafi i dytë i Kodit Civil, nuk duhet të autorizohet nga ortakët blerja nga ana e shoqërisë për një shumë të barabartë ose më të lartë se një e dhjeta e kapitalit të shoqërisë, të të mirave ose kredive të ortakëve themelues, të ortakëve ose të administratorëve, në dy vite të regjistrimit të shoqërisë në rregjistrin e ndërmarjes.

11.2 Nuk mund të marrin pjesë në vendime si në format sipas nenit 11.3 pasardhës si në formën e nenit 12 në vijim, ortakët vonestar dhe ortakët titullar të pjesëmarrjes për të cilët ligji disponon shprehimisht pesullimin e të drejtës së tyre të votës.

11.3 Vendimet e ortakëve, me përjashtim përsa përmendet në nenin 12, janë zbatuar mbi bazën e konsensusit të shprehur me shkrim.

11.4 Për vendimet e marra duke adoptuar sistemin e konsensusit të shprehur me shkrim duhet të jetë hartuar një dokument i shkruar i njëjtë nga i cili duhet të rezultojnë me qartësi:

- argumenti objekt i vendimit

- përmbajtja dhe rezultatet e vendimit dhe autorizimet e mundshme përkatëse

Një kopje e këtij dokumenti duhet të jetë transmetuar të gjithë ortakëve të cilët Brenda pesë ditëve pasardhëse duhet ti transmetojnë shoqërisë deklaratën përkatëse, të shkruar në kopjen e dokumentit të marrë, në të cilën duhet të shprehin votën e tyre të favorshme ose kundër ose abstenimin, duke treguar, nëse konsiderohet e nevojshme, motivi i kundërshtimit të tyre ose abstenimit; mungesa e deklaratës nga ortakët brenda afatit si më lart është ekuivalente me një votë kundër

Dorëzimi i dokumentave sipas parashikimeve të këtij paragrafi mund të kryhet me çfarëdolloj mënyre dhe/ose sistem komunikimi që lejon një ballafaqim të dërgimit dhe marrjes, duke përfshirë dhe faksin dhe posten elektronike.

11.5 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet për të cilat në këtë nen dhe vota e tij vlen në masë proporcionale me pjesëmarrjen e saj.

11.6 Vendimet e ortakëve janë marrë me votën e shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën 60% (gjashtëdhjetë për qind) dhe të kapitalit të

shoqërisë. Mbeten gjithsesi përvec dispozitave të tjera të këtij statuti që për vendime të vecanta kërkojnë shumicë specifike.


11.7 vendimet e ortakëve, të zbatuara sipas këtij neni, duhet të jenë të transkriptuara, pa vonesë, në Librin e vendimeve të ortakëve.

#### Art. 12 Asamblea

12.1 Duke ju referuar lëndëve të përmendura në nenin paraardhës 11.1 në pikat d) dhe e), në të gjithë rastet e tjera të parashikuar nga ligji ose nga ky akt kushtetues, ose kur e kërkojnë një ose më shumë administratorë ose një numur ortakësh që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë, vendimet e ortakëve duhet të jenë të zbatuara nëpërmjet shqyrtimit të asamblesë sipas metodës kolegjiale.

12.2 Për këtë qëllim asamblea duhet të mbledhet nga Organi Administrativ edhe jashtë Komunës, ku është vendosur selia e shoqërisë, vetëm nëse në Itali ose në rrethin teritorial të Kombeve që I përkasin Bashkimit Europian. Në këtë rastin e fundit është i rëndësishëm autorizimi preventiv I ortakëve sipas nenit paraardhës 11.

12.3 Asamblea thirret nga Presidenti i Këshillit të Administratës ose nga një prej Administratorëve me me njoftim të dërguar të paktën 6 (gjashtë) ditë para afatit të fiksuar për mbledhjen, me letër rekomande, ose me anën e cdo lloji mjeti tjetër të përshtatshëm për të siguruar provën e marrjes së njoftimit, të dërguar ortakëve në adresën sipas librit të ortakëve. (në rastin e thirrjes nëpërmjet telefaksit, postës elektronike ose mjeteve të



tjera të ngjashme, njoftimi duhet dorëzuar në numrin e telefaksit, në adresën e postës elektronike ose në adresën specifike që është komunikuar më parë. Njoftimi duhet të bëhet menjëherë nga ortaku dhe rezulton nga libri i ortakëve. Në njoftimin e mbledhjes duhet të jetë treguar dita, vendi, ora e mbledhjes dhe lista e lëndëve që do të trajtohen.

12.4 Në njoftimin e thirrjes mund të parashikohet një datë e mëvonshme për një mbledhje të dytë për rastin në të cilin mbledhja e parashikuar në thirrjen e parë, asamblea nuk do të rezultonte ligjërish e mbledhur; megjithatë dhe në mbledhjen e dytë vlejné të njëjtat shumica të parashikuara për mbledhjen e parë. Njoftimi mund të parashikojë mbledhje të tjera për të cilat L'avviso potrà prevedere ulteriori convocazioni per le quali vigono le medesime maggioranze previste per le precedenti.

12.5 Në mungesë të mbledhjes formale, asamblea përsëritet rregullisht e mbledhur kur marr pjesë kapitali i plotë i shoqërisë dhe të gjithë Administratorët dhe Sindikalistët, nëse janë emëruar, janë të pranishëm ose të informuar dhe asnjë nuk I kundërvihet trajtimit të argumentit.

Në rast të tillë Asamblea mund të mbahet në vende të ndryshme nga ato të përmendura në nenin 12.2 pa asnjë autorizim parandalues. Nëse administratorët ose sindikalistët, nëse janë emëruar, nuk marrin pjesë personalisht në asamble, duhet të lenë një deklaratë përkatëse me shkrim, për tu ruajtur në aktet e shoqërisë, në të cilën deklarojné të jenë

informuar për të gjitha argumentat e vendosura në rendin e ditës dhe të mos kundërshtojnë trajtimin e tyre.

Artikulli 13 Zhvillimi i Asamblesë

Asamblea kryhesohet, sipas strukturës së organit administrative nga Administratori I Vetëm (sipas rastit në nenin pasues 16.1 pika a), nga Kryetari I Këshillit të Administrimit ( sipas rastit në nenin 16.1 pika b) ose nga Administratori më I vjetër ( sipas rastit në nenin pauses 16.1 pika c). Në mungesë ose pengese të këtyre, Asamblea do të kryhesohet nga personi I zgjedhur me votën e shumicën e të pranishmëve.

13.2 Asamblea zgjedh një sekretar edhe jo ortak,dhe po të jetë e nevojshme një ose më shumë vëzhgues jo ortakë.

13.3 I takon Kryetarit të Asamblesë të konstatojë kushtetueshmërinë e rregullt, të pranojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të drejtojë dhe rregullojë zhvillimin e asamblesë dhe të vërtetojë dhe sigurojë zhvillimin e asamblesë, së asamblesë dhe të vërtetojë ose proklamojë rezultatet e votimit.

13.4 Mbledhjet e Asamblesë, të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, me të pranishëm të shpërndarë në më shumë vende, të afërta ose në distancë, të lidhura me audio/video, mund të mbahen sipas kushteve të mëposhtme, të cilat do të pasqyrohen në procesverbal:

- që të jenë të pranishëm në tën njëjtin vend Kryetari dhe sekretari i mbledhjes të cilët do të sigurojnë formimin dhe nënshkrimin e procesverbalit.

- që ti jetë lejohe Kryetarit të Asamblesë të pranojë identitetin e ligjshmërisë së të pranishmëve, rregullojë zhvillimin e mbledhjes, konstatojë dhe proklamojë rezultatet e votimit.

- Ti lejohe subjektit që mban procesverbalin të perceptojë në mënyrë të përshtashmengjarjet e asamblesë object I procesverbalit.

- që ti lejohe të pranishmëve të marrin pjesë në diskutimin dhe votimin simultan me argumentat e rendit të ditës, për më tepër, të vizionojë, marrë apo presë transfertë dokumentash.

- që tregohen në faturën e mbledhjes (përvec kur trajtohe për asamble të mbajtur sipas nenit 12.5) vendet audio/video të lidhura nën kujdesin e shoqërisë, në të cilat të pranishmit mund të marrin pjesë, për të mbajtur zhvillimin e mbledhjes ku do të jenë kryetari dhe subjekti I procesverbalit, duhet ndër të tjera të ketë gjithashtu shumë fletë ku janë vendet audio/video të lidhura në të cilat zhvillohet mbledhja.

#### Neni 14 e drejta e votës dhe kuorumi i asamblesë

14.1 Secilit ortak i takon një numër proporzional votash në pjesëmarrjen e tij.

14.2 Kanë të drejtë të jenë të pranishëm në asamble ata ortakë që në datën e asamblesë rezultojnë të regjistruar në librin e ortakëve.

14.3 Çdo ortak që ka të drejtë pjesëmarrjeje në asamble mund të përfaqësohet nga një delegim me shkrim, i cili duhet të ruhet nga shoqëria.

Delegimi nuk mund të lëshohet me emrin e përfaqësuesit të lënë bosh.

Përfaqësuesi mund të zëvendësohet vetëm nga ai person që është treguar shprehimisht në delegim, përveç rastit nëse është avokat i përgjithshëm.

Nëse delegimi jepet vetëm për një asamble, është e vlefshme edhe për mbledhjet e ardhshme.

Pranohet edhe delegimi i përgjithshëm i cili vlen për shumë asamble, pavarësisht nga rendi i ditës.

Përfaqësimi nuk mund ti jepet, as administratorëve, as eksertëve kontabël (ose revizorit) nëse janë emëruar, as nënpunësve të shoqërisë, as shoqërive që kontrollohen prej tyre ose që e kontrollojnë, ose anëtarëve të organeve administrative ose të kontrollit ose nënpunësve të tyre.

14.4 Asamblea është thelemuar rregullisht më praninë e shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën 60% (gjashtëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë.

14.5 Asambleja miraton, me shumicën e të pranishmëve, mënyrat e votimit, me propozim të Kryetarit. Vota duhet të jetë e qartë ose sidoqoftë duhet të shprehet me mënyrën e tillë që të përcaktohen ortakët që nuk janë në një mendje.

14.6 Asambleja e themeluar rregullisht në bazë të paragrafit të mëparshëm vendos me votë të favorshme të shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën 60%



(gjashtëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë, përveç rasteve kur është parashikuar nga neni i mëparshëm 11.1 pika d) dhe e) në të cilat gjithmonë kërkohet domosdoshmërisht vota e shumë ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 95% (nëntëdhjetë për qind) I kapitalit të shoqërisë.

Qëndrojnë sidoqoftë vec dispozitat e tjera të këtij statuti që për vendime të veçanta kërkojnë formimin e shumicave të tjera specifike.

#### Neni 15 Proçes verbal i Asamblesë

15.1 Vendimet e Asamblesë duhet të dalin nga proçes verbali i nënshkruar nga Kryetari dhe nga sekretari ose noteri, nëse kërkohet nga ligji.

15.2 Proçes verbali duhet të tregojë datën e asamblesë dhe, bashkëngjitur, identitetin e pjesëmarrësve dhe kapitalin e përfaqësuar nga secili; gjithashtu duhet të tregojë menyrat dhe rezultatet e votimit dhe duhet të pranojë, edhe bashkëngjitur, identifikimin e ortakëve të favorshëm, obstenues ose që nuk janë në një mendje. Në proçes verbal duhet të përmbliidhen, me kërkesë të ortakëve, deklaratat e tyre në lidhje më rendin e ditës.

15.3 Proçes verbali në lidhje më vendimet assembleare qe sjellin ndryshimet e këtij akt themelimi duhet të hartohet nga një noter.

15.4 Proçes verbali i asamblesë, edhe pse i hartuar me akt publik, duhet të hidhet në të pastër, menjëherë, në librin e Vendimeve të ortakëve.

#### Neni. 16 Administrimi

16.1 Shoqëria mund të administrohet, alternativisht, sipas sa është vendosur nga ortakët me rastin e emërimit:

a) nga një administrator i vetëm;

b) nga Këshilli i Adminstrimit i përbërë nga një numër i ndryshueshëm anëtarësh nga një minimum prej dy në një maksimum prej shtatë anëtarësh, sipas numrit të saktë që do të përcaktohet nga ortakët në rast emërimi;

c) nga dy ose më shumë Administratorë me kompetenca të përbashkëta dhe/ose të ndara, në numër dhe me kompetenca që do të vendosen nga ortakët në rast emërimi.

16.2 Administratorët mund të mos jenë ortakë. Nuk mund të emërohen me detyrën e administratorit dhe nëse emërohen humbasin të drejtën nga zyra ata që ndodhen në kushtet e parashikuara nga neni 2382 i kodit civil.

16.3 Administratorët nuk janë subjekt i ndalimit të konkurrencës sipas nenit 2390 të kodit civil.

#### Neni 17 Emërimi dhe zëvendësimi i administratorëve

17.1 Administratorët do të qëndrojnë ne detyrë deri në revokim ose dorëheqje ose për kohën e kufizuar që do të vendoset nga ortakët në aktin e emërimit të tyre.

17.2 Në rast emërimi deri në revokim ose dorëheqje, është pranuar revokimi i administratorëve në çdo kohë dhe pa nevojshmëri motivimi, ose për çështje të drejtë.

17.3 Lejohet rizgjedhja.

17.4 Në rast se është emëruar Këshilli i Administrimit sipas nenit të mëparshëm 16.1 pika b), nëse për çfarëdo lloj arsyeje vjen më pak se shumica e Këshilltarëve bie i gjithë Këshilli i Administrimit. Në rast se janë emëruar më shumë Administratorë, me kompetenca të përbashkëta dhe/ose të ndara në bazë të nenit të mëparshëm 16.1 pika c), nëse për çfarëdo lloj arsyeje jep dorëheqjen qoftë edhe një Administrator i vetëm, bien të gjithë Administratorët. Do të takojë ortakëve me vendim të tyre të procedojnë me emërimin e organit të ri Administrativ. Ndërkohë Këshilli i rrëzuar ose administratorët e tjerë të rrëzuar mund të përmbushin të vetmet akte të administrimit të zakonshëm.

17.5 Pushimi i administratorëve për shkak të skadencës së afatit ka efekt nga momenti në të cilin organi i ri administrativ është rithemeluar.

#### Neni. 18 Kryetari

18.1 Në rast se shoqëria është administruar nga një Këshill Administrimi, emëruar në bazë të nenit të mëparshëm 16.1 pika b), ai zgjedh midis anëtarëve të saj Kryetarin, në rast se ky nuk është emëruar nga ortakët në momentin e emërimit të këshillit, dhe ndoshta edhe një ZëvendësKryetar që do të zëvendësojë Kryetarin në rastin e mungesës ose ndalimit, si dhe një sekretar, qoftë edhe i jashtëm.

#### Neni 19 Vendimet e Administratorëve

19.1 Në rast se shoqëria administrohet nga një Këshill Administrimi, emëruar në bazë të nenit të mëparshëm 16.1 pika b), vendimet e tij, përveç sa është

parashikuar në nenit pasues 20.1, janë marrë nëpërmjet konsultimit të shkruar ose mbi bazën e konsensusit të shprehur me shkrim, në bazë të asaj që do të vendoset nga Këshilli në mbledhjen e parë pas emërimit.

19.2 Në rast se vendoset për sistemin e konsultimit të shkruar duhet të hartohet një dokument i shkruar përkatës, nga i cili duhet të rezultojnë me qartësi:

- argumenti i objektit të vendimit
- përmbajtja dhe rezultatet e vendimit dhe autorizimet e mundshme përkatëse.
- treguesin e Administratorëve që pranojnë
- treguesin e Administratorëve kundër ose abstenues, dhe me kërkesë të tyre treguesin e motivit të kundërshtimit të tyre ose abstenimit;
- nënshkrimi i të gjithë Administratorëve, si i atyre që pranojnë ashtu edhe atyre abstenues dhe kundër.

19.3 Në rast se vendoset për sistemin e konsultimit të shkruar duhet të hartohet një dokument i shkruar përkatës, nga i cili duhet të rezultojnë me qartësi:

- argumenti i objektit të vendimit
  - përmbajtja dhe rezultatet e vendimit dhe autorizimet e mundshme përkatëse
- Kopja e këtij dokumenti duhet ti jepet të gjithë administratorëve të cilët brenda dy ditëve të ardhshme duhet ti japin shoqërisë deklaratë përkatëse, shkruar në fund të kopjes së dokumentit të marrë, në të cilën duhet të shprehin voton e tyre të favorshme ose kundër ose abstenim, duke treguar,

nëse konsiderohet e nevojshme, motivi i kundërshtimit të tyre ose abstenimit; mungesa e deklarimit të administratorëve brenda afatit të sipërmendur është ekuivalente me votë kundër.

Transmetimet e parashikuara në këtë paragraf mund të ndodhin me çfarëdolloj mjete dhe/ose sistemi i komunikimit që pranon një ballafaqim të dërgesës me mandatin, duke përfshirë faksin dhe postën elektronike.

19.4 Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me votë të favorshme të shumicës së Administratorëve në detyrë.

19.5 Vendimet e administratorëve, adaptuara në bazë të këtij neni, duhen hedhur në librin e vendimeve të Administratorëve.

19.6 Me shumicën si në nenin 19.4, administratorët mund të vendosin që për vendime mbi argumenta të veçanta ose për operacione specifike të shprehet me vendim Këshilli Administrativ kolegjisht.

#### Neni 20 Vendime kolegjinale të administratorëve

20.1 Duke iu referuar çështjeve të treguara nga neni 2475 paragrafi i pestë i kodit civil ose në rast kur neni i mëparshëm 19.6 ose në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji ose nga ky akt themelues, vendimet e Këshillit Administrativ, që është emëruar sipas nenit të mëparshëm 16.1 pika b), duhet të adaptohen nëpërmjet vendosjes kolegjinale.

20.2 Për këtë qëllim Këshilli i Administrimit:

- mblidhet nga Kryetari nëpërmjet njoftimit të dërguar me letër rekomande, ose, me çfarëdo lloj tjetër mjete i përshtatshëm për këtë qëllim (për

shembull faks, postë elektronike), të paktën pesë ditë përpara mbledhjes dhe në rast urgjence me telegram ose fax të dërgohet të paktën tre ditë përpara, në të cilat përcaktohen datat, vendi dhe ora e mbledhjes, si dhe rendi i ditës.

- mblihet pranë selisë së shoqërisë ose në vend tjetër, por që të jetë në Itali.

20.3 Mbledhjet e Këshillit dhe vendimet e saj janë të vlefshme, edhe pas mbledhje formale, kur janë të pranishëm të gjithë Këshilltarët në detyrë dhe Revizorët e emëruar, dhe kur janë paraqitur ose informuar për mbledhjen, në këtë rast mund të mbahet edhe në vend të ndryshëm nga ai i treguar në nenin 20.2.

20.4 Është e mundur që mbledhjet e Këshillit të Administrimit të mbahen me të pranishmit e zhvendosur në më shumë vende të lidhura me audio/video, dhe kjo në kushtet e mëposhtme, për të cilën duhet të vërehet në proçes verbalet përkatëse:

a) që të jenë të pranishëm në të njëjtin vend Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes që do të sigurojnë formimin dhe nënshkrimin e proçes verbalit, ku duhet të zhvillohet mbledhja në vendin e thënë;

b) që ti lejohet Kryetarit të mbledhjes të vërtetojë identitetin e të pranishmëve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, konstatojë dhe shpallë rezultatet e votimit;

c) që ti lejohet subjektit verbalizues që të përceptojë përshtatshmërisht ngjarjet e mbledhjes objekt të proces verbalizimit;

d) që ti lejohet të pranishmëve të marrin pjesë në diskutimin dhe në votimin simultan mbi argumentat e rendit të ditës, si dhe, të shohë, të marrë ose të transmetojë dokumenta.

20.5 Këshilli i administrimit vendos vlefshmërisht, në formë kolegjiale, me praninë efektive të shumicës së anëtarëve të saj në detyrë dhe shumicë absolute të votave të të pranishmëve. Në rast barazie propozimi supozohet i kundërshtuar. Vota nuk mund të jepet me përfaqësim.

20.6 Vendimet e Këshillit të Administrimit të zbatuara në bazë të këtij neni janë konstatuar nga proces verbali i nënshkruar nga Kryetari dhe nga Sekretari; ky proces verbal, edhe pse i hartuar me akt publik, duhet të hidhet në të pastër, në Librin e vendimeve të Administratorëve.

20.7 Vendimet e këshillit të Administrimit mbi lëndën e rezervuar kompetencave të saja në bazë të nenit të ardhshëm 33.3 duhet të zbatohen me vendim kolegjial në bazë të këtij neni, që të rezultojnë nëpërmjet proces verbalit të hartuar nga Noteri me akt publik.

#### Neni 21. Kompetenca të administratorëve

21.1 Organi administrativ, çfarëdo qoftë struktura e saj, ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, duke përjashtuar atë çfarë ligji i rezervon shprehimisht ortakëve.

Megjithatë do të jetë e nevojshme një autorizim paraprak i ortakëve, me vendim të marrë me votën e favorshme të shumë ortakëve që përfaqësojnë më shumë, së 95% (nëntëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë, për përfshirjen e akteve të mëposhtme:

- marrja përsipër e huave, dorëzaneve dhe hapjes së kredive në përgjithësi pranë instituteve dhe shoqërive të kredive, me apo pa garanci për shumën më të mëdha se 1.000.000,00 euro (një milion presje zero zero);

- shit-blerjen, dhënien dhe marrjen me qira të ndërmarrjeve ose degëve të ndërmarrjeve;

- themelimin e shoqërive të çdo lloji, Konsorciumeve dhe të enteve kolektive të çdo lloji;

- blerjen edhe kalimin e pjesëmarrjeve dhe interesave të çdo lloji tipi;

- çdo veprim me pasuritë e paluajtshme, duke përfshirë themelimin dhe tjetërsimin e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, që të kalojnë vlerën prej 1.000.000,00 Euro (një milion presje zero zero) e marrë veçmas dhe nëse e fraksionuar ti referohet një kontraktimi unitar.

21.2 Në rast emërimi të Këshillit të Administrimit (në bazë të nenit 16.1 pika b) ai mund t'ia delegojë të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij në normat dhe kufijtë e caktuar në nenin 2381 të kodit civil dhe pikës së mëparshme 21.1) një komiteti ekzekutiv të përbërë nga disa prej anëtarëve të tij ose njërit ose më shumë se një prej anëtarëve të tij, edhe të ndarë. Komiteti ekzekutiv ose administratori ose Administratorët e deleguar, mund



të përmbushin të gjitha aktet e Administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, që do të rezultojnë nga delegimi i dhënë nga Këshilli i Administrimit.

21.3 Rast emërimi të më shumë Administratorëve, me kompetenca të përbashkëta dhe/ose të ndara (në bazë të nenit të mëparshëm 16.1 pika c), kompetencat e administrimit, me rastin e emërimit, mund ti jepen atyre si bashkarisht asntu edhe të ndarë, ose ndonjë kompetencë administrimi mund ti jepet në mënyrë të ndarë dhe të tjerat bashkarisht. Në mungesë të çfarëdolloj saktësie në aktin e emërimit në lidhje me mënyrat e ushtrimit të kompetencave të administrimit, këto kompetenca do të konsiderohen të dhëna bashkarisht administratorëve. Përveç kufijve të pikës së mëparshme 21.1.

21.4 Organi administrativ mund të emërojë drejtorë, përfaqësues ose avokatë për përmbushjen e akteve të përcaktuara ose kategori aktesh, duke i përcaktuar kompetencat; për emërimin do të jetë e nevojshme autorizim paraprak i ortakëve nëse i jepen kompetenca për përmbushjen e akteve sipas pikës të mëparshme 21.1.

21.5 Mungesa e një autorizimi paraprak e ortakëve, sa herë që kjo të kërkohet për përmbushje të një akti të administrimit, sjell përgjegjësinë e organit administrativ në bazë të nenit 2476 të kodit civil dhe përbën një shkak të drejt për revokimin e tij.

## Neni 22 Përfaqësimi i shoqërisë

22.1 Administratorët kanë përfaqësimin e përgjithshëm të shoqërisë.

22.2 Në rast të emërimit të këshillit të Administrimit në bazë të nenit të mëparshëm 16.1 pika b), përfaqësimi i shoqërisë do të takojë të gjithë menëtarëve të Këshillit të Administrimit, në mënyrë të ndarë midis tyre.

22.3 Në rast emërimi të më shumë Administratorëve, me kompetenca të bashkëta dhe/ose të ndara (në bazë të nenit të mëparshëm 16.1 pika c),

përfaqësimi i takon atyre bashkarisht ose veçmas sipas kompetencave të administrimit, në rastin e emërimit, i janë dhënë atyre bashkarisht ose veçmas.

22.4 Përfaqësimi i shoqërisë i takon edhe drejtorëve, drejtorëve të përgjithshëm, përfaqësuesve dhe avokatëve si në nenin e mëparshëm 21 në kufijtë e kompetencave të përcaktuara nga Organi Administrativ në aktin e emërimit.

#### Neni 23 Kompensimi i administratorëve

23.1 Administratorëve, përveç rimbursimit të shpenzimeve të mbajtura për ushtrimin e funksioneve të tyre, mund ti caktohet një kompensim vjetor i përgjithshëm, edhe në formën e pjesëmarrjes në të ardhurat, që do të caktohet nga ortakët, në rastin e emërimit ose me vendim përkatës.

23.2 Në rast se shoqëria do të administratohet nga Këshill Administrimi, shpërblimi i administratorëve të veshur me detyra të veçanta është vendosur nga vetë këshilli, duke marrë dhe mendimin e kolegjit të ekspertëve nëse është emëruar. Tek ortakët mund të përcaktojnë një shumë të përgjithshme për

shpërblimin e të gjithë administratorëve, duke përfshirë edhe ata të veshur me detyra të veçanta.

23.3 Organi administrativ mund ti jepet gjithashtu e drejta për perceptim të një shpërblimi për qëllim raportin e bashkëpunimit të kordinuar dhe të vazhdueshëm, për tu themeluar nëpërmjet kursimeve vjetore ose nëpërmjet police përkatëse siguracioni, që do të përcaktohet nga Ortakët, me rastin e emërimit ose me vendim përkatës.

#### Neni 24 Organi i kontrollit

24.1 Si një organ kontrolli, ortakët, me vendim të marrë në bazë të nenit 11 të mëparshëm, mundet eventualisht të emërojnë, alternativisht:

- Kolegji i Ekspertëve Kontabël, që duhet të emërohet dhe që do të veprojë në bazë të nenit 25 të mëposhtëm, ose
- një Revizor, që duhet të emërohet dhe që do të veprojë në bazë të nenit 26 të ardhshëm.

24.2 Emërimi i Kolegjit të Ekspertëve Kontabël është e detyrueshme që të verifikohen kushtet e vendosura nga neni 2477 të kodit civil. Edhe në këtë rast Kolegji i Ekspertëve Kontabël do të emërohet dhe do të veprojë në bazë të nenit 25 të ardhshëm.

#### Neni 25 Përbërja dhe kompetenca të Kolegjit të Ekspertëve Kontabël

25.1 Kolegji i Ekspertëve Kontabël përbëhet nga tre anëtarë efektivë dhe dy shtesë. Kryetari i Kolegjit të Ekspertëve Kontabël është emëruar nga ortakët, me vendim emërimi të vetë Kolegjit.

25.2 Ekspertët janë emëruar, ku ortakët vendosin kështu ose emërimi është i detyrueshëm me ligj, për herë të parë në aktin e themelimit dhe në vazhdim nga ortakët. Ata qëndrojnë në detyrë për tre vite ushtrimore, dhe skadojnë në datën e vendimit të ortakëve për miratimin e bilancit në lidhje me vitin e tretë ushtrimor të detyrës. Pushimi i ekspertëve për mbarimin e afatit ka efekt nga momenti në të cilin kolegji është rithemeluar. Ekspertët mund të rizgjidhen.

25.3 Nuk mund të emëohen në detyrën e Ekspertit dhe nëse është emëruar bien nga detyra ata që gjenden në kushtete e parashikuara nga neni 2399 i kodit civil.

25.4 Ekspertët mund të revokohen vetëm për çështje të drejtë dhe me vendim të ortakëve, të merren me shumicë absolute të kapitalit të shoqërisë. Vendimi i revokimit duhet të miratohet me dekret të gjykatës, duke degjuar të interesuarin.

25.5 Në rast vdekjeje, mospranimi oseose humbja e së drejtës e një eksperti, vijjnë ekspertët shtesë me rradhë etj. Ekspertët e rinj qëndrojnë në detyrë deri në vendimin e ortakëve për plotësimin e kolegjit, vendim që do të merret në tridhjetë ditët e ardhshme. Të emëruarit e rinj i skadon afati bashkë me ata në detyrë.

Në rast zëvendësimi i kryetarit, kryesia merret përsipër deri në vendimin për plotësim nga eksperti më i vjetër.

25.6 Kolegji i Ekspertëve Kontabël ka detyrat dhe kompetencat sipas nenit 2403 dhe 2403/II të kodit civil dhe gjithashtu ushtron kontrollin kontabël; në lidhje me këtë Kolegji i Ekspertëve Kontabël duhet të themelohet përësisht nga Revizorë Kontabël të regjistruar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu aplikohen dispozitat e nenëve 2406 dhe 2407 të kodit civil.

25.7 Paga vjetore e ekspertëve është e përcaktuar nga ortakët në aktin e emërimit për të gjithë kohëzgjatjen e zyrës së tyre.

25.8 Për mbledhjet e Kolegjit të Ekspertëve Kontabël duhet të mbahet proces verbal, i cili duhet të hidhet në Librin e vendimeve të Kolegjit të Ekspertëve Kontabël dhe nënshkruar nga të pranishmit; vendimet e Kolegjit të Ekspertëve Kontabël duhet të merren me shumicë absolute të të pranishmëve. Eksperti që nuk është në një mendje ka të drejtë që të shkruajë me proces verbal arsyet e kundërshtimit të tij.

Ekspertët duhet të asistojnë në mbledhjet e asambleve në rastet e nenit 12, në mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe të Komitetit ekzekutiv në rastet e nenëve 16.1 pika b), 21.2 dhe 33.

25.9 Çdo ortak mund të denoncojë faktet që i konsideron të ndalueshme Kolegjit të Ekspertëve Kontabël, i cili duhet të mbajë parasysh denoncimin në raportin vjetor mbi bilancin; nëse denoncimi është bërë nga shumë ortakë që përfaqësojnë një të njëzetën e kapitalit të shoqërisë, Kolegji i

Ekspertëve Kontabël duhet të hetojë pa u vonuar mbi faktet e denoncuara dhe të paraqesë konkluzionet e tij dhe propozime të mundshme asamblesë.

Si alternativë aplikohet dispozita e nenit 2409 të kodit civil.

#### Neni 26 Revizor kontabël

26.1 Si alternativë të Kolegji i Ekspertëve Kontabël (përveç në rastit e emërimit të detyruar të Kolegjit në bazë të nenit 2477 të kodit civil) kontrolli kontabël i shoqërisë mund të ushtrohet nga një Revizor i regjistruar në Regjistrin pranë Ministrisë së Drejtësisë.

26.2 Nuk mund të emërohet në detyrën e Revizorit dhe nëse është emëruar bie nga detyra, ai që gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 2399 i kodit civil.

26.3 Revizori përkatës është përcaktuar nga ortakët në aktin e emërimit për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes të zyrës së tyre.

